



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202400493/5

Tiranë ___/___/2024

Lënda: Rekomandim për marrjen e masave, për garantimin e të drejtës për arsim të fëmijës me incialet R.N, me aftësi të kufizuara në interesin më të lartë të tij

BASHKISË TIRANË

ZYRËS ARSIMORE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR TIRANË

SHKOLLËS 9-VJEÇARE "ALI DEMI"

SHKOLLËS 9-VJEÇARE "1 MAJI"

TIRANË

Për dijeni:

Z. A. N.

TIRANË

Të nderuar,

Institucioni i Avokatit të Popullit (AP), në mbështetje të pikës 1, të nenit 60, të Kushtetutës, si dhe të ligjit nr. 8454, datë 4.02.1999, "Për Avokatin e Popullit" të ndryshuar (ligji nr.8454/1999), mori në shqyrtim ankesën e shtetasit A. N., prind i një fëmije me aftësi të kufizuar (AK). Kjo ankesë adreson problematikën e vështirësive për aksesin në shkollë të vajzës së tij me incialet R.N., të datëlindjes 30.04.2015, e cila këtë vit shkollor ishte nxënëse në klasën e I-rë, të shkollës 9-vjeçare "1 Maji", Tiranë. Vajza ka aftësi të kufizuar lëvizëse, ka statusin e para-tetraplegjikut (diagnoza "spasti

cerebrale”), sipas librezës së SHSSH, me numër vendimi 5517¹. Për shkak të kësaj diagnoze ajo lëviz me karrocë, e në këto kushte r mitura nuk ka mundësi të mëvetshme aksesi në klasë. Infrastruktura shkollore nuk është e përshtatur për aftësinë e kufizuar.

Gjatë vitit shkollor 2022-2023 ajo ka ndjekur ciklin parashkollor në këtë shkollë, pasi klasa ishte në katin e pare. Ndërkohë për vitin shkollor 2023-2024, klasa e parë ishte caktuar ta zhvillonte mësimin në katin e tretë të godinës së shkollës. Për shkak të mungesës së ashensorit në shkollë, ankuesi (babai i saj) detyrohej ta ngjiste në krahë vetë fëmijën deri në katin e tretë, e në fund të mësimit ta zbresë po në krahë. Fëmija asistohet nga një mësuese ndihmëse 10 orë në javë.

Nga dokumentacioni që prindi i fëmijës i ka bashkëngjitur ankesës së tij, rezulton se me datën 18.05.2023 i është drejtuar me një kërkesë Zyrës Vendore Arsimore Tiranë, që të merreshin masa për vendosjen e një ashensori në shkollë, si dhe për prezencën e një tualeti të përshtatshëm për nxënësit me AK, në mënyrë që vajza e tij të mund të vijonte shkollën normalisht kur të fillonte viti shkollor në Shtator 2023.

Zyra Vendore Arsimore Tiranë i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike, Bashkia Tiranë, nëpërmjet shkresës “Për marrje masash”² duke i paraqitur nevojën e vendosjes së një ashensori në shkollën 9-vjeçare “1 Maji” Tiranë, si dhe të përshtatjes së një tualeti, për nxënësit me AK.

Po ashtu, edhe Ministria e Arsimit dhe Sportit, referuar shkresës me nr.3251/1 prot., më datë 24.05.2023, ka përcjellë kërkesën e prindit të fëmijës për trajtimin, bazuar në legjislacionin në fuqi, Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës, Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Tiranë.

Problematika e aksesit në shkollën 9-vjeçare “1 Maji”, të fëmijës, është bërë edhe objekt shqyrtimi pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Ky i fundit, në përfundim të hetimit administrativ, ka nxjerrë vendimin³ me rekomandimet përkatëse, ndërmjet të cilave:- Konstatimin e diskriminimit të fëmijës R. N, në të drejtën për arsim, për shkak të aftësisë së kufizuar, nga ana e Bashkisë Tiranë; - Bashkia Tiranë, duhet të marrë masa për të siguruar në mënyrë të përshtatshme aksesueshmërinë në Shkollën 9-vjeçare “1 Maji”, në Tiranë, në përputhje me standardet ligjore në fuqi dhe për të gjitha

¹Me vlefshmëri nga data 01.01.2023 deri me datë 01.01.2026

² Shkresa me nr.2200/1 prot., datë 19.05.2023

³<https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2024/03/Vendim-nr.-47-date-14.02.2024-R.H-kunder-Bashkise-Tirane-Diskriminim.pdf>

kategoritë e personave me aftësi të kufizuara; - Bashkia Tiranë, duhet të marrë masa për hartimin e një plani masash për evidentimin e të gjitha objekteve arsimore, në juridiksionin e saj, për të cilat nevojitet aksesueshmëria, me qëllim parandalimin e situatave diskriminuese ndaj të gjithë personave me aftësi të kufizuara. Pjesë e planit të masave duhet të jetë planifikimi progresiv i fondeve të nevojshme për përshtatjen dhe përcaktimi i afateve kohore për realizimin e përshtatshmërisë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit që ankuesi ka paraqitur në institucionin e AP-së, rezulton se nga Bashkia Tiranë janë dërguar disa shkresa për trajtimin e kësaj problematike. Konkretisht:

Me shkresën nr.65/2 prot., datë 24.01.2024, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike, Bashkia Tiranë i drejtohet Drejtorisë së Përgjithshme të Punëve Publike, në Bashkinë Tiranë, duke e bërë me dije se në objektin Shkolla “1 Maji” kërkohet që të krijohet mundësia për vendosjen e një ashensori (pasi shkolla nuk ka klasa në katin përdhe) në shërbim të fëmijëve me AK dhe me qëllim krijimin e kushteve optimale dhe aksesueshmërisë për PAK. Në vijim, në shkresë është sqaruar se një ndërhyrje e tillë për ndryshimin e projektit fillestar të godinës i kalon kufijtë e mirëmbajtjes dhe për pasojë është përtej kompetencave të kësaj drejtorie, pasi Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike ka si detyrë themelore mirëmbajtjen e objekteve publike. Ndërkohë, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit dhe Monitorimit të Punëve Publike, me shkresën nr.4049/1 prot., datë 21.02.2024, kjo çështje i kalohet për kompetencë dhe dhënien e një zgjidhjeje të rastit, Zyrës Vendore Arsimore Tiranë. Nga përmbajtja e kësaj shkrese evidentojmë se “...meqënëse shkolla “1 Maji” nuk ka klasa në katin e parë, kërkohet të shqyrtohet mundësia e sistemimit të fëmijës në një shkollë alternative, siç mund të jetë shkolla 9-vjeçare “Ali Demi” ose “Kosova”, të cilat plotësojnë kriteret për aksesimin në shkollë të fëmijës”.

Për sa më sipër rezulton se ky vit shkollor (2023-2024) u përmbyll në këto kushte për ankuesin dhe vajzën e tij me AK, ndaj ankuesi paraqiti ankesën për këtë problematikë dhe për ndërhyrjen e institucionit të Avokatit të Popullit, për aksesin e fëmijës në shkollë. Ai ndër të tjera ka vlerësuar në ankesë punën dhe përkushtimin e stafit drejtues, pedagogjik e social të kësaj shkolle, si dhe mësuesit ndihmës për mbarëvajtjen e fëmijës në mësim.

Në mbështetje të nenit 13, të ligjit nr.8454/1999, institucioni i AP-së, pasi mori dijeni për problematikën nga ankesa e prindit të fëmijës, filloi procedurën e shqyrtimit të çështjes për fëmijën me inicialet R.N., për garantimin e aksesit dhe të drejtës për një arsimim të denjë.

Nëpërmjet shkresës me nr. K5/S2-2 Prot., datë 03.05.2024, ju drejtuam Bashkisë Tiranë dhe Zyres Vendore Arsimore Tiranë, për të parashtruar problematikën e mangësive të infrastrukturës (si rampa sipas standarteve, tualete të përshtatur për fëmijët me AK, dhe ashensor).

Në kthim përgjigjen e saj, Zyra Vendore Arsimore Tiranë (ZVA)⁴ na bën me dije se mirëmbajtja, rikonstruksionet, rindërtimet apo nevojat që kanë godinat e institucioneve arsimore parauniversitare, nuk janë në kompetencën dhe inventarizimin e kësaj zyre, por të Bashkisë Tiranë. Kjo problematikë nga ana e ZVA-së është ndjekur hap pas hapi dhe është adresuar me prioritet në institucionet e vartësisë të Bashkisë Tiranë (si Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve Publike dhe Drejtorisë së Planifikimit të Punëve Publike).

Po ashtu, Sektori i Njesisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit, të Njesisë Administrative nr.2 Tiranë⁵, ka informuar se fëmija R.N. me status para-tetraplegjik, në kujdestari të znj.J.F.H., trajtohet nga ky sektor i Njesisë nr.2 Tiranë dhe nga komunikimi i vazhdueshëm i PMF-së me drejtoreshën, psikologjen e punonjësen sociale të shkollës 9-vjeçare “1 Maji”, rezulton se:

Në shkollën 9-vjeçare “1 Maji” është bërë e mundur:

- përshtatja e një karrigeje për të lehtësuar qëndrimin e fëmijës gjatë procesit mësimor;
- tualeti është krijuar në kushte të favorshme dhe përdoret vetëm nga e mitura R.N;
- rampa gjithashtu ndodhet në katin e parë dhe është përshtatur me vetë strukturën e shkollës.

Deri në kohën kur fëmija ka kryer arsimin parashkollor çdo gjë ka qenë e menaxhueshme, pasi klasa ka qenë në katin e parë, por nisur nga organizimi i brendshëm i shkollës, aktualisht mësimi për klasën e parë zhvillohet në katin e tretë. Prandaj, prindërve ju është sugjeruar nga stafi mësimor që në bazë të interesit më të lartë të fëmijës, të bëjnë transferimin në shkollën “Ali Demi”, që është shkollë më e përshtatshme dhe me kushte më të favorshme, si dhe me distancën më të afërt për fëmijën.

Drejtorja e Përgjithshme e Investimeve të Punëve Publike, Bashkia Tiranë ia ka kaluar për kompetencë shkresën e Avokatit të Popullit, Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit dhe Monitorimit të Punëve Publike, me shkresën nr.17886/1 prot., datë 27.05.2024, për trajtimin e kësaj problematike në përputhje me legjislacionin në fuqi.

⁴ Shkresa me nr.2859/1 prot., datë 09.05.2024

⁵ Shkresa me nr.2065/1 prot., datë 13.05.2024

Në zbatim të ligjit nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe nenit 78 të Udhëzimit nr.31, datë 28.01.2020 “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në RSH” e drejta e transferimit nga një institucion arsimor në një tjetër realizohet nëpërmjet kërkesës së kujdestarit ligjor të nxënësit.

Në vijim të trajtimit të rastit, institucioni i Avokatit të Popullit kreu dy takime e monitorime të situatës në dy shkollat 9-vjeçare, “1 Maji” dhe “Ali Demi”. Nga këto takime rezultoi disponueshmëri dhe dëshirë e mirë nga stafi drejtues e pedagogjik në shkollën “1 Maji” për gjetjen e një zgjidhjeje sa më të shpejtë dhe efektive për aksesin e fëmijës në shkollë. Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson punën e mirë të kryer nga shkolla “1 Maji”, për zhvillimin e procesit arsimor për fëmijën me inicialet R.N., por shpreh shqetësimin e tij institucional, për sa i përket vijimit të këtij procesi në këtë shkollë, në kushtet në të cilat ajo ofron. Në katin e parë të kësaj shkolle nuk kishte mundësi për zhvendosjen e klasës së fëmijës R.N në katin e parë. Mundësia e vetme për aksesin në këtë shkollë të fëmijës me AK (që lëviz me karrige me rrota) do të ishte vendosja e një ashensori.

Institucionet përgjegjëse të arsimit kanë bërë përpjekje, duke i dhënë zgjidhje të përkohshme realizimit të të drejtës për arsim të fëmijës R.N. Gjithashtu këto institucione i janë drejtuar Bashkisë Tiranë për marrjen e masave për plotësimin e standardeve të infrastrukturës së shkollave me qëllim për t’i kthyer ato në mjedise të aksesueshme për fëmijët me aftësi të kufizuara, përfshi dhe rastin e nxënëses R.N.

E drejta për arsimim është një nga të drejtat themelore të njeriut, e cila duhet të gëzohet në mënyrë të njëjtë dhe të barabartë nga të gjithë. Kushtetuta e RSh-së në nenet 57 dhe 59 të saj garanton të drejtën për arsim për të gjithë fëmijët dhe të rinjtë pa dallim. Në këtë kontekst, fëmijë me aftësi të kufizuara gëzojnë të drejtën për t’u arsimuar sipas nevojave, të përcaktuara nga strukturat përgjegjëse të vlerësimit të aftësisë së kufizuara⁶.

Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ka përcaktuar shkollën, si institucioni që ofron shërbim arsimor për nivelet, arsim fillor, arsim i mesëm i ulët dhe arsim i mesëm i lartë. Sipas nenit 32 të këtij ligji, institucioni arsimor ka për detyrë krijimin e mjedisit miqësor për nxënësit dhe të mundësive që secili nxënës të shfaqë, të zhvillojë individualitetin dhe të realizojë potencialin e tij në

⁶ Komenti i Përgjithshëm nr.9 (2006), Komiteti i Gjenevës për të Drejtat e Fëmijëve, “Të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara”, CRC/C/GC/9, 27.2.2007.

përputhje me këtë ligj⁷. Në këtë kuadër, shkollat duhet të bëjnë vetë një vlerësim të kushteve infrastrukturore që kanë, në mënyrë që kur të regjistrohen fëmijë me AK të jenë të gatshme t'u ofrojnë kushtet dhe aksesin për të cilat këta fëmijë kanë nevojë.

Njësia bazë e qeverisjes vendore⁸, ka si detyrë përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit arsimor për të gjithë nxënësit në institucionet arsimore parauniversitare publike e në këtë detyrë përfshihen edhe ndërtimi dhe rikonstruksioni i godinave të institucioneve arsimore publike, sipas standarteve të miratuara nga Këshilli i Ministrave, me fonde të buxhetit të shtetit ose me fonde nga transferta e pakushtëzuara ose të ardhurat e veta⁹.

Pengesa infrastrukturore në ndërtesën e Shkollës 9-vjeçare “1 Maji”, (rindërtuar në vitin 2016) Tiranë (mospasja e një ashensori) ka passjellë vështirësitë për fëmijën, në aksesin për arsim, vështirësi që padiskutim me rritjen e fëmijës, vetëm shtohen. Ndërkohë, nisur nga parimi i interesit më të lartë të fëmijës, për gjetjen e një zgjidhjeje sa më të shpejtë të çështjes, nga rrethanat faktike dhe inspektimi në vend, konsiderojmë se zgjidhja më optimale për aksesin e fëmijës me AK është transferimi në shkollën 9-vjeçare “Ali Demi”, Tiranë. Kjo e fundit jo vetëm që ka kushte më të përshtatshme për të akomoduar fëmijën R.N, por është gjithashtu më afër vendbanimit të familjes. Në këtë shkollë ka mundësi që klasa e fëmijës (e dyta për vitin shkollor 2024-2025) të zhvendoset në katin e parë të godinës.

Vazhdimësia e punës në ofrimin e shërbimeve edukative për fëmijët me AK, kërkon një qasje gjithëpërfshirëse dhe shumëdimensionale, për të bashkëpunuar dhe bashkërenduar punën me institucionet e tjera jashtë shkollës (p.sh. me Zyrën Vendore Arsimore, Njësinë e qeverisjes vendore, prindërit, etj.). Në këtë frymë është e rëndësishme, që nxënësve me aftësi të kufizuara t'u sigurohen shërbime rehabilituese dhe mësues ndihmës¹⁰, të cilët procedojnë nëpërmjet programeve të specializuara dhe të personalizuara për secilin nxënës me aftësi të kufizuar¹¹. Pra puna e mirë, në ndihmë të

⁷ Neni 2, pika 20.

⁸ Neni 28 i ligjit 69/2012.

⁹ Sipas Vendimit nr.319, datë 12.04.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e standarteve të projektimit të shkollave”, të ndryshuar.

¹⁰ Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, nr.15, datë 24.07.2023 “Për vitin shkollor 2023-2024 në sistemin parauniversitar”¹⁰, në nenin 6, ka përcaktuar se DRAP/ZVAP në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe me drejtuesit e institucioneve arsimore parauniversitare duhet të ndjekin me përparësi: j-Ngritjen dhe funksionimin e komisioneve multidisiplinare për kryerjen e vlerësimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe caktimin e mësuesve ndihmës sipas legjisllacionit në fuqi. m-Hartimin dhe zbatimin e Planeve Edukative Individuale (PEI) për fëmijët me aftësi të kufizuara.

¹¹ Pika 2 e nenit 65, të ligjit nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

frekuentimit të rregullt të mësim, duhet të vijojë me fëmijën edhe për këtë vit shkollor¹².

Angazhimi kryesor që “Asnjë të mos mbetet pas” përbën parimin kyç të të gjitha Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm. Shteti duhet të prioritizojë rolin parësor të familjes në mbrojtjen e fëmijëve dhe të sigurojë kujdesin dhe mbështetjen e duhur në mënyrë që çdo vendim të merret mbi bazën e interesave më të larta të fëmijës¹³. Zbatimi i Agjendës 2030 “Për Zhvillimin e Qëndrueshëm”¹⁴ është thelbësor, për sigurimin e mirëqënies dhe gëzimit të të gjithë të drejtave për fëmijët.

Ky rekomandim është në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, të institucionit të Avokatit të Popullit në procesin e zbatimit dhe monitorimit të Agjendës 2030 të Kombeve të Bashkuara. Konkretisht objektivi 4.5 i kësaj Agjende thekson rëndësinë e sigurimit të një arsimit gjithëpërfshirës dhe me cilësi të barabartë me qëllim promovimin e mundësive të të mësuarit përgjatë gjithë jetës, duke eliminuar pabarazitë gjinore në arsim dhe sigurimin e një qasjeje të barabartë në të gjitha nivelet e arsimit për personat në nevojë, përfshirë **personat me aftësi të kufizuara**.

Aksesueshmëria duhet të sigurohet për të gjithë personat me aftësi të kufizuara, pavarësisht nga lloji i aftësisë së kufizuar dhe përbën një nga parimet themelore të Konventës për të Drejtat e Aftësisë së Kufizuar (KDPAK)¹⁵. Neni 24 i Konventës së OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPAK) parashikon jo vetëm që fëmijët me aftësi të kufizuara nuk duhet të diskriminohen, por edhe se ata duhet të jenë në gjendje të kenë akses në sistemin e arsimit të përgjithshëm, bazuar në parimin e barazisë. Kjo nënkupton të drejtën për të mos u veçuar dhe për t’ju siguruar

¹² Rregullorja “Për funksionimin e institucioneve Arsimore Parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, në pikën 1 të nenit 80, i cili dedikohet arsimimit të fëmijëve me aftësi të kufizuar, përcakton se, Zyra Vendore Arsimore (ZVA) ngre Komisionin Multidisiplinor të përbërë nga një mjek peditër (kur është e mundur, mjek peditër zhvillimi), një psikolog, një punonjës social, një mësues (kur është e mundur, mësues i kualifikuar për arsimin e specializuar) dhe drejtuesi i Njësisë së Shërbimit Psiko-Social, duke përcaktuar në këtë mënyrë punën e çdo strukture, përfshirë dhe prindërit, në lidhje me arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuar. Komisioni me kërkesën e personit që ushtron përgjegjësinë prindërore të fëmijës ose të drejtorit të IA-së, ku fëmija është regjistruar, vlerëson nevojat arsimore të fëmijës dhe ecurinë e tij dhe “personi që ushtron përgjegjësinë prindërore i paraqet Komisionit në ZVA raportin vlerësues të fëmijës së tij të kryer nga komisioni mjekësor, kur fëmija është vlerësuar nga ky komision mjekësor”. Është pikërisht Komisioni në ZVA i cili “njofton personin që ushtron përgjegjësinë prindërore për gjendjen dhe ecurinë e fëmijës” dhe “bazuar në rekomandimin e Komisionit Multidisiplinor cakton mësuesin ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuar sipas nevojave individuale të tyre”.

¹³Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, 26.07.2019 “Status of the Convention of the Rights of the Child-Report of the Secretary General”, 68 session

¹⁴ Kombet e Bashkuara (2015). Të transformojmë botën tonë: Axhenda për Zhvillimin e Qëndrueshëm 2030. Marrë nga <https://sustainabledevelopment.un.org/post2015/transformingourworld/publication>, e aksesueshme në dhjetor 2015

¹⁵Ratifikuar me ligjin nr. Nr. 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”

atyre të gjithë mbështetjen që u nevojitet. Të gjitha barrierat duhet të hiqen - qofshin këto barrierë ligjore, fizike, komunikuese dhe gjuhësore, sociale, financiare dhe sjelljeje.

Ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara” ka përkufizuar se:

“*Persona me aftësi të kufizuara*” janë individët që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose ndijore, dëmtime të cilat, në bashkëveprim me pengesat e ndryshme, përfshirë ato mjedisore dhe të qëndrimit, mund të pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efikase të këtyre personave në shoqëri, në kushte të barabarta me të tjerët”¹⁶.

“*Aksesueshmëri*” është mënjanimi i pengesave të të gjitha llojeve¹⁷.

Më tej, termi “Pengesat” nënkupton:

- a) pengesat sociale, veçanërisht qëndrimet, stereotipet e sjelljen tutelore;
- b) pengesat mjedisore, përfshirë vështirësitë në komunikim që kanë personat me dëmtime ndijore, veçanërisht ata me dëmtime në shikim dhe dëgjim, ata për të cilët komunikimi verbal është i kufizuar ose i pamundur e personat që kërkojnë formate të thjeshta për t’u lexuar dhe për t’u kuptuar;
- c) pengesat infrastrukturore, përfshirë ato në banesa, hapësira dhe shërbime publike;
- ç) pengesat institucionale, përfshirë ato në legjislacion dhe politika”.

Pra, legjislacioni e ka sanksionuar garantimin e aksesueshmërisë nëpërmjet mënjanimi të pengesave të të gjitha llojeve dhe se jetesa e pavarur e personave me aftësi të kufizuar mund të sigurohet nëpërmjet garantimit të aksesueshmërisë, përfshirë edhe aksesin në arsim.

Referuar rasteve kur përfshihen fëmijë, është e rëndësishme që institucionet përgjegjëse të ndërmarrin veprime konkrete për të garantuar të drejtën e arsimimit të fëmijës, sidomos të atyre me gjendje fizike të veçanta. Gjithashtu, sjellim në vëmendje, se e drejta e çdo fëmije për t’u arsimuar, siç e parasheh neni 18, i ligjit nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, ku fëmija ka të drejtën e aksesit dhe të frekuentimit të arsimimit falas e cilësor, në bazë të mundësive të barabarta dhe pa diskriminim, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar, është një e drejtë themelore e patjetërsueshme. Autoritetet përgjegjëse, eliminojnë të gjitha barrierat infrastrukturore, sociale, mjedisore, institucionale dhe ligjore në fushat e arsimit...që fëmijët me aftësi të kufizuara të ushtrojnë të drejtat e parashikuara në ligjin 18/2017¹⁸. Në këtë kontekst, të dy institucionet, Avokati i Popullit dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi kanë

¹⁶ Neni 3, pika 9

¹⁷ Neni 3, pika 1

¹⁸ Neni 32 i ligjit 18/2017 “Fëmija me aftësi të kufizuara”.

drejtuar disa rekomandime për përmirësimin e aksesueshmërisë për fëmijët me AK.

Në Strategjinë Kombëtare të Arsimit 2021-2026¹⁹ parashikohen ndër të tjera, si objektiva edhe:

“A1.3.5. Përmirësimi i aksesueshmërisë së fëmijëve me aftësi të kufizuara në çdo shkollë dhe në të gjitha mjediset e shkollës.

A1.6.1. Investime për përmirësimin dhe përshtatjen e infrastrukturës shkollore. Kjo infrastrukturë do të përshtatet për aksesin e nxënësve me aftësi të kufizuara fizike, por edhe sa i takon aspekteve të higjienës, duke respektuar nevojat e veçanta të vajzave dhe djemve, si dhe aspekteve të sigurisë”.

Një nga objektivat kryesorë të VKM-së nr.276, datë 12.05.2021 “Përmirësimin e Planit Kombëtar për personat me aftësi të kufizuara 2021-2025”²⁰, është *sigurimi dhe ofrimi i arsimit gjithëpërfshirës dhe cilësor për të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara.*

Edhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) ka vënë në dukje rëndësinë e parimeve themelore të universalitetit dhe mosdiskriminimit në realizimin e të drejtës për arsim. Për më tepër, mbrojtja e personave me aftësi të kufizuara përfshin një detyrim për shtetet që të sigurojnë “akomodim të arsyeshëm” për t'u lejuar personave me aftësi të kufizuara mundësinë për të realizuar plotësisht të drejtat e tyre. Gjykata ka konsideruar se “akomodimi i arsyeshëm” mund të marrë forma të ndryshme, qoftë fizike apo jofizike, arsimore apo organizative, për sa i përket aksesit nga pikëpamja arkitekturore të ndërtesave shkollore, trajnimit të mësuesve, përshtatjes kurrikulare apo objekteve të përshtatshme; (*Çam kundër Turqisë, 2016, 66; Enver Şahin kundër Turqisë, 2018, 61; G.L. kundër Italisë, 2020, 63*).

Institucioni i Avokatit të Popullit në trajtimin e çdo lloj rasti ankese apo kërkese të shtetasve, ka nënvizuar se **interesi më i lartë i fëmijës** duhet të jetë kryesori në çdo lloj vendimmarrje të organeve shtetërore. Në sistemin e monitorimit të zbatimit të të drejtave të fëmijëve në Shqipëri, Avokati i Popullit synon që jo vetëm të promovojë të drejtat e fëmijëve, por dhe të luajë rolin parandalues, mbrojtës, nxitës dhe proaktiv për aksesin në shërbimet e ndryshme ekonomike, arsimore, shëndetësore që ndikojnë tek fëmijët. Pra, përveç zgjidhjes së problemit konkret, përpiqemi të promovojmë interesin më të lartë të fëmijës, si parësori në punën e administratës publike, duke pasur parasysh gjithashtu që fëmijët, për shkak të veçorive të moshës, të mungesës

¹⁹ Miratuar me VKM nr.621, datë 22.10.2021

²⁰ <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2021/05/12/276/0426afc6-f905-4823-b2dd-1947a8fab811>

së pjekurisë fizike dhe intelektuale, kanë nevojë për mbrojtje dhe vëmendje të veçantë nga familja dhe institucionet shtetërore.

Përfshirja e prindërve dhe komunitetit është i rëndësishëm për cilësinë e arsimit dhe gjithëpërfshirjen, në klasë dhe jashtë saj. Hapi i parë për ndërgjegjësimin dhe fuqizimin e prindërve dhe familjeve për t'u përfshirë në një mënyrë bashkëpunuese me shkollat është promovimi i një atmosfere sociale dhe edukative ku prindërit të ndjehen të mirëpritur, të respektuar, të besojnë që fjala e tyre dëgjohet dhe të ndjehen të dobishëm.

Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës, duke vënë në dukje zhvillimet pozitive që kanë ndodhur në kuadrin ligjor dhe rregullator në avancimin e të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara, ka sjellë në vëmendje Komentin e tij të Përgjithshëm nr. 9 (2006) mbi të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe i ka rekomanduar, së fundmi, shtetit shqiptar²¹:

(e) Të sigurojë aksesin në shkolla, qendra të kujdesit shëndetësor dhe hapësirat publike, ndërtesa, shërbime dhe informacion për fëmijët me aftësi të kufizuara;

(f) Të forcojë kapacitetin e profesionistëve për të punuar dhe mbështetur familjet e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Në mbështetje të objektivave 4.1-4.7 dhe 4.a të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, Komiteti i ka rekomanduar gjithashtu ndër të tjera shtetit shqiptar²²:

(b) Sigurimin e arsimit gjithëpërfshirës në mjediset e edukimit të fëmijërisë së hershme dhe shkollat e zakonshme për të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara duke përshtatur kurrikulat dhe trajnimin dhe duke caktuar mësues dhe profesionistë të specializuar në klasa të integruara, në mënyrë që fëmijët me aftësi të kufizuara dhe vështirësi në të nxënë të marrin mbështetje të individualizuar dhe vëmendjen e duhur, duke u ofruar transportin dhe sigurimin e akomodimit të arsyeshëm në shkolla.

Ndërmjetësimi dhe vlerësimi duhen bërë në bashkëpunim mes prindit të fëmijës dhe institucioneve përkatëse shtetërore e arsimore, duke u përpjekur të shmangen qëndrime strike që janë në dëm të fëmijës.

Për sa më sipër, në funksion të garantimit të interesit më të lartë të fëmijës dhe të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, në mbështetje të

²¹Pika 32 e Konkluzioneve përfundimtare mbi raportet 5 dhe 6 të Shqipërisë, shtator 2023

²² Pika 39 e Konkluzioneve të Komitetit të KDF

nenit 21, të ligjit nr.8454/1999, me qëllim garantimin e të drejtës së arsimit për fëmijën me aftësi të kufizuara, Avokati i Popullit,

REKOMANDON:

- Marrjen e masave nga institucionet arsimore, **pas marrjes së pëlqimit të prindit**, për të mundësuar transferimin e fëmijës R.N., nga shkolla 9-vjeçare “1 Maji” tek shkolla 9-vjeçare “Ali Demi”, Tiranë.
- Marrjen e masave për bashkëpunimin dhe bashkërendimin e punës midis strukturave të shërbimit psiko-social të dy shkollave 9-vjeçare “1 Maji” dhe “Ali Demi” me Punonjësin për Mbrojtjen e Fëmijës/Njësia Administrative nr.1, Tiranë për krijimin e një mjedisi miqësor për fëmijën R.N, nga nxënësit dhe stafi pedagogjik i shkollës “Ali Demi” nëse ajo transferohet për vitin e ri shkollor 2024-2025.
- Marrjen e masave nga Bashkia Tiranë, për të siguruar në mënyrë të përsheptuar kushtet dhe aksesueshmërinë për fëmijët me aftësi të kufizuara në shkollat 9-vjeçare “1 Maji” dhe “Ali Demi” Tiranë, në përputhje me standardet ligjore në fuqi në bashkëpunim me vetë këto shkolla.
- Marrjen e masave nga Bashkia Tiranë për të vlerësuar të gjitha institucionet arsimore në juridiksionin e saj, me qëllim identifikimin e problemeve që duhen zgjidhur për të garantuar aksesueshmërinë në këto institucione të personave me aftësi të kufizuara.
- Marrjen e masave nga Zyra Vendore Arsimore Tiranë për vlerësimin e nevojave për mësues ndihmës, sipas numrit të fëmijëve me AK në shkollat “Ali Demi” dhe “1 Maji” dhe vënia në dispozicion e mësuesve ndihmës për fillimin e vitit të ri shkollor 2024-2025.

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr.8454/1999, organet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandime, duhet t’i shqyrtojnë ato dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditë nga data e dërgimit.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin dhe, në vijim të bashkëpunimit, lutemi shqyrtimin e këtyre rekomandimeve.

KOMISIONER

Olta ALIAJ